

V E N D I M
Nr.406, datë 19.6.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

a) Në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

- Në klasifikimin “A8” shtohet emërtimi “Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve”, i cili shfuqizohet në klasifikimin “B1”.

- Në klasifikimin “A12” shtohet emërtimi “Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Burgjeve”, i cili shfuqizohet në klasifikimin “B3”.

- Në klasifikimin “B3” shtohet emërtimi “Drejtor në burgje dhe institucione riedukimi”, i cili shfuqizohet në klasifikimin “B4”.

b) Në lidhjen II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, paragrafi “Emërtime të tjera për punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë”, ndryshohet si më poshtë vijon:

-“Drejtor i Përgjithshëm i BurgjeveA8

- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Burgjeve.....A12

- Drejtor në burgje dhe institucione riedukimi.....B3.”.

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano